



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË REFORMËS TË FINANCAVE PUBLIKE

Konsultimi i tretë me Shoqërinë Civile për hartimin e Planit të Veprimit  
të OGP 2020-2022\_Transparenca Fiskale

**14 Tetor, ora 14.00**

**Takim virtual në EebEx**

Konkluzionet

Të mërkurën, datë 14 Tetor ora 14.00 u organizua takimi i tretë konsultues me Organizatat e Shoqërisë Civile për të prezantuar procesin dhe punën paraprake për Komponentin e Transparencës Fiskale. Në takim morën pjesë grupi i punës dhe përfaqësues nga disa Shoqata Civile të ftuar, identifikuar sipas listeprezenes bashkëlidhur.

Në takim u zhvilluan pikat sipas axhendes së përcaktuar më parë:

1. Koordinator i MFE referoi një prezantim për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur për hartimin e Planit të Veprimit të OGP 2020-2022\_Komponenti i Transparencës fiskale, rekomandimet e lëna në kuadër të OGP-së për komponentin e transparencës fiskale dhe objektivat specifike; masat paraprake të identifikuar nga konsultimi paraprak dhe rekomandimet e OSHC-ve në këtë konsultim;
2. Pas përfundimit të prezantimit, fjala i kaloi OSHC-ve prezente për pyetje apo komente lidhur me prezantimin ose për të propozuar idetë e tyre në këtë proces.

**Znj. Trebicka, Eksperte pranë Qendrës Europartners Developments** bëri disa komente lidhur me procesin, si: krijimi i mundësisë për aksesimin e materialeve për të gjithë të interesuarit, rrjedhimisht materialet e punuara dhe prezantuara sugjeroi që në vijim të ishin në gjuhën shqipe. Gjithashtu, ekspertja shtroi tre pika specifike që mund të konsiderohen në punën e metejshme të qeverisë për përmirësimin e transparencës fiskale:

1. *Rekomandimi i parë ishte lidhur me transparencën e buxhetit në nivel vendor*: në vijim të punës së bërë nga projekte në nivel vendor për përgatitjen e dokumentit Buxhetit të Qytetarit në nivel

vendor (Bashkie), i cili është prodhuar dhe publikuar tashmë, të punohet për thjeshtëzimin e gjuhës dhe paraqitjes së dokumentit që të jetë i kuptueshëm për cdo audience.

2. *Rekomandimi i dytë ishte lidhur me transparencën e buxhetit në nivel qendror*: Specifikisht, në fazën e zbatimit të buxhetit, pavarësisht punës së bërë në publikimet periodike të raporteve të ekzekutimit të buxhetit, është e rëndësishme që në vijim të punohet për thjeshtëzimin e këtyre raporteve që të jenë të kuptueshëm nga qytetar dhe jo vetëm për ekspertët e buxhetit.

3. *Rekomandimi i tretë*, lidhet me një nga rekomandimet e mëparshme të OSHC-ve ‘*publikimi i kontratave koncesionare*’ për të cilin u vlerësua puna e deri tanishme dhe që janë të publikuara në regjistrin e kontratave koncesionare, por duhej të punohej më tepër për monitorimin e autoriteve koncesionare në bazë të performancës, pra për zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve përkatëse.

Pas marrjes së këtyre ideve, koordinatori i MFE vlerësoi kontributin dhe cilësoi që këto ide do të shyrtohen me qëllim adresimin e masave të mundshme si pjesë e PV OGP 2020-2022, ndërsa për pikën e tretë, sqaroi që duke nisur nga viti 2019, ka nisur të forcohet roli i MFE-së në monitorimin e kontratave koncesionare, pas hyrjes në fuqi të Ligjit ‘Për PPP dhe Koncesionet’ ndryshuar në 2019 dhe në këtë drejtim ka nisur të prodhohet dhe publikohet raporti për monitorimin e kontratave koncesionare, i cili përmban informacion mbi performancën e koncesionarit gjatë zbatimit të kontratës. Po punohet në vazhdim për të rritur numrin e kontratave që do të monitorohen periodikisht.

**Znj. Toska, Eksperte pranë Co-plan**, komentoi dhe propozoi se si kjo iniciative mund të jetë efektive, dhe në këtë drejtim puna duhet të nisë nga diagnostifikimi i problemeve në fazat e para dhe jo në hallken e fundit që është monitorimi dhe auditimi, pra duhet të plotësohen disa parakushte që të promovohet dhe rritet transparenca fiskale. Ekspertja, trajtoi praktikisht katër pika/para kushte kryesore për të cilat duhet punuar:

1. *Operabiliteti i Bashkive në Sistemin e Thesarit AGFIS*. U cilësua që aktualisht, një pjesë e madhe e bashkive, përveç asaj të Tiranës vazhdojnë të procedojnë me shkresa fizike, si dhe të mbajnë pasqyrat financiare në excel (apo rrallë herë në programe financiare si alpha, financa 5 etj). Ndaj u sugjerua që fillimisht të punohet për aksesimin e institucioneve vendore në AGFIS.

2. *Sistem kontabilitet unik-u* theksua nevoja dhe rëndësia që të gjithë bashkitë duhet të përdorin dhe zbatojnë të njëjtat standarte kontabiliteti, pasi kjo shkakton probleme më tej për gjurmimin, auditimin dhe monitorimin e informacionit.

3. *Sistemi i taksapaguesve të jetë i njëjtë për të gjitha bashkitë, pasi bashki të ndryshme i trajtojnë ndryshe taksat që menaxhojnë.*

4. *Publikimi dhe aksesimi i të dhënave të Statistikave Financiare Qeveritare për publikun, duke ilustruar me shembull sistemin e BSH i cili paraqet dhe publikon statistikën në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme.*

Koordinatori i OGP falenderoi për problematikat e adresuara dhe cilësoi që disa nga këto sugjerime janë pjesë e masave të propozuara dhe do të trajtohen në vazhdim për tu adresuar në planin e veprimit.

Si konkluzion para mbylljes së takimit u ra dakort që Shoqëritë Civile prezente dhe kontributore do të sjellin propozimet dhe në formë të shkruar nëpërmjet emailit apo pyetsorit që të dokumentohen si evidence për procesin konsultues.

Gjithashtu u ra dakort që dokument në vijim do të përcillen dhe me email sikurse proceduar deri në këtë fazë si dhe do të publikohen në website të OGP për çështje vizibiliteti.

<http://ogp.gov.al/artikull/komponenti-4-fiskale>